

USHTRIMI I PROVËS SË  
REZISTENCËS SË SEKTORIT  
BANKAR NË SHQIPËRI

Juna Bozdo  
Arisa Goxhaj (Saqe)  
Adam Gersl

6 (87) 2024

ALTERNATIVE STUDIOR






**USHTRIMI I PROVËS SË  
REZISTENCËS SË SEKTORIT  
BANKAR NË SHQIPËRI**

*Juna Bozdo  
Arisa Goxhaj (Saqe)  
Adam Gersl*

**6 (87) 2024**

**MATERIALI STUDIMOR**

**BANKA E SHQIPËRISË**



### Juna Bozdo

Departamenti i Stabilitetit Financiar, Banka e Shqipërisë, e-mail: [jbozdo@bankofalbania.org](mailto:jbozdo@bankofalbania.org)

### Arisa Goxhaj (Saçe)

Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme,  
Banka e Shqipërisë., e-mail: [asaçe@bankofalbania.org](mailto:asaçe@bankofalbania.org)

### Adam Gersl

Universiteti "Charles", Pragë, Republika Çeke.

## SHËNIME

*Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë material janë vetëm të autorëve dhe nuk reflektojnë këndvështrimin dhe opinionin e Bankës së Shqipërisë.*

# P Ë R M B A J T J E

<b>ABSTRAKT</b>	<b>7</b>
<b>1. HYRJE</b>	<b>8</b>
<b>2. DY FJALË MBI SEKTORIN BANKAR SHQIPTAR</b>	<b>10</b>
<b>3. USHTRIMI I PROVËS SË REZISTENCËS NË BANKËN E SHQIPËRISË GJATË PERIUDHËS 2007-2021</b>	<b>17</b>
<b>4. METODOLOGJIA E RE E USHTRIMIT TË PROVËS SË REZISTENCËS</b>	<b>26</b>
<b>5. REZULTATET E PROVËS SË REZISTENCËS TË KRYER NË FILLIM TË VITIT 2022</b>	<b>38</b>
<b>6. KONKLUZIONE DHE SFIDAT E SË ARDHMES</b>	<b>45</b>
<b>REFERENCA</b>	<b>46</b>



## ABSTRAKT

Ky material diskutimi përshkruan evoluimin e ushtrimit të provës së rezistencës së sektorit bankar të zbatuar në Bankën e Shqipërisë gjatë 15 viteve të fundit. Punimi jep detaje rreth metodologjive të këtij ushtrimi të përdorura përgjatë kësaj periudhe kohore, me fokus kryesor në dy qasjet e fundit: atë të përdorur gjatë periudhës 2013-2021 dhe veçanërisht, atë aktuale, pra qasjen e re që prej vitit 2022. Punimi paraqet të dy qasjet e mësipërme duke prezantuar rezultatet e ushtrimeve të kryera në dy momente të ndryshme kohore (2019 dhe 2022), si dhe diskuton mbi sfidat e ardhshme në këtë fushë.

*Fjalë kyçe: ushtrimi i provës së rezistencës; rreziku i kredisë; bankë qendrore; mjaftueshmëria e kapitalit; stabiliteti financiar*  
*Klasifikimi JEL: E44, E58, G21, G28.*

## 1. HYRJE

Stabiliteti financiar përfaqëson aftësinë e sistemit financiar për të kryer me efikasitet funksionet e tij, jo vetëm në rrethana normale, por edhe në situata më të pafavorshme ekonomike. Stabiliteti financiar është një kusht i domosdoshëm që sistemi financiar të jetë në gjendje të japë hua për ekonominë reale dhe të mbështesë një rritje të qëndrueshme ekonomike. Nëse ruhet stabiliteti financiar, institucionet financiare janë të qëndrueshme ndaj goditjeve ekonomike, krizat financiare shmangen dhe politikat ekonomike të bankës qendrore dhe autoriteteve të tjera publike janë më efektive.

Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me autoritetet e tjera, kontribuon në ruajtjen e stabilitetit financiar. Në vitin 2007, në Bankën e Shqipërisë u krijua Departamenti i Stabilitetit Financiar për të vëzhguar dhe vlerësuar rreziqet ndaj stabilitetit financiar dhe për të mbështetur diskutimet dhe vendimmarrjen institucionale dhe ndër-institucionale për këtë çështje<sup>1</sup>. Pas krizës globale, rëndësia e ruajtjes së stabilitetit financiar është rritur më tej. Kuadri ligjor është përshtatur në vitin 2016, duke zgjeruar objektivat e Bankës së Shqipërisë përtej ruajtjes tradicionale të stabilitetit të çmimeve dhe rregullimit të mbikëqyrjes bankare, duke përfshirë edhe një objektiv për parandalimin dhe zbutjen e rrezikut sistemik<sup>2</sup>. Rreziku sistemik nënkupton materializimin e goditjeve kur paqëndrueshmëria financiare bëhet aq e përhapur saqë cënon funksionimin e sistemit financiar në masën që rritja ekonomike dhe mirëqenia ndikohen në mënyrë thelbësore<sup>3</sup>.

Për të vlerësuar rreziqet ndaj stabilitetit të sistemit financiar dhe kryesisht rrezikun sistemik, Banka e Shqipërisë përdor një sërë mjetesh analitike për të vëzhguar dhe analizuar në mënyrë periodike ekonominë reale dhe sektorin financiar dhe, në varësi të rezultateve të analizave, vë në zbatim instrumente makroprudenciale që

---

<sup>1</sup> Këshilli Mbikëqyrës miratoi rregulloren "Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar", sipas Vendimit nr. 52, datë 26.09.2007.

<sup>2</sup> Ligji nr.133/2016, datë 22.12.2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë".

<sup>3</sup> Hollo et al. (2011).



synojnë zbutjen e këtyre rreziqeve<sup>4</sup>. Një nga mjetet e tilla analitike është ushtrimi i provës së rezistencës së sektorit bankar, i cili synon vlerësimin e kapacitetit të sektorit bankar për të përthithur humbjet që vijnë nga materializimi i ngjarjeve ekstreme, por të besueshme, dhe të pafavorshme në kuadrin makroekonomik dhe në sektorin financiar. Banka e Shqipërisë ka kryer rregullisht ushtrime të provës së rezistencës së sektorit bankar që prej vitit 2007.

Objektivi i këtij materiali është të përshkruajë evolucionin dhe përvojën e Bankës së Shqipërisë në ushtrimet e provës së rezistencës të kryera në Bankën e Shqipërisë sipas qasjes nga lart-poshtë, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e bankave në situata të pafavorshme makroekonomike. Metodologjia e ushtrimit të provës së rezistencës është zhvilluar përgjatë 15 viteve të fundit, dhe bazuar në të dhënat dhe sfidat e reja, qasja e saj është përshtatur vazhdimisht. Ne e vëmë theksin në metodologjinë dhe qasjen aktuale të hartuar gjatë vitit 2021 dhe e ilustruam atë duke paraqitur rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës të përdorur në Raportin e Stabilitetit Financiar të publikuar në prill 2022 (Banka e Shqipërisë, 2022).

Pjesa tjetër e materialit është organizuar si më poshtë: Seksioni 2 përshkruan karakteristikat kryesore të sektorit bankar shqiptar dhe kuadrin rregullativ të tij për t'i dhënë lexuesit njohuritë e përshtatshme. Seksioni 3 shqyrton historikun e ushtrimeve të provës së rezistencës të kryera në Bankën e Shqipërisë që prej vitit 2007, duke përshkruar shtyllat kryesore të metodologjisë së zbatuar përgjatë periudhës 2007-2021. Seksioni 4 paraqet metodologjinë aktuale të ushtrimit të provës së rezistencës të përdorur që prej fillimit të vitit 2022, ndërsa seksioni 5 ilustron përdorimin e tij dhe rezultatet e provës së rezistencës të kryera në fillim të vitit 2022 dhe të publikuar në Raportin e Stabilitetit Financiar në prill 2022. Seksioni 6 paraqet përmbledhjen e punimit dhe trajton sfidat e ardhshme në këtë fushë.

---

<sup>4</sup> *Strategjia e Politikës Makroprudenciale është miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 38, më 2 gusht 2017. Objektivi kryesor i saj është të ofrojë një kuadër të përgjithshëm operacional për zbatimin e politikës makroprudenciale. Në vijim, Banka e Shqipërisë miratoi rregulloren nr. 41, datë 05.06.2019, "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit", qëllimi i së cilës është përcaktimi i mënyrës së zbatimit të secilës prej shtesave makroprudenciale të kapitalit dhe kombinimi i tyre.*

## 2. DY FJALË MBI SEKTORIN BANKAR SHQIPTAR

Marrëdhënia ndërmjet rritjes ekonomike dhe zhvillimit financiar është diskutuar gjerësisht në literaturën teorike. Kjo e fundit ka treguar se një sistem financiar i zhvilluar mirë mbështet dhe nxit stabilitetin financiar të një vendi, duke ndikuar edhe në stabilitetin makroekonomik të tij<sup>5</sup>.


Në një këndvështrim të tillë, sektori bankar shqiptar, me një peshë të aktiveve prej rreth 94% të PBB-së në fund të vitit 2021, është segmenti më i rëndësishëm i sistemit financiar shqiptar (duke zënë pothuajse 90% të totalit të aktiveve të sistemit financiar, ku pjesa e mbetur prej 10% përfshin huadhënës të tjerë si: institucionet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit, fondet e pensioneve dhe kompanitë e sigurimit).

Sektori ka pësuar zhvillime dinamike gjatë tre dekadave të fundit. Gjatë viteve 1990, u krijua infrastruktura përkatëse ligjore dhe institucionale, ish-bankat shtetërore u privatizuan dhe lojtarë të rinj, përfshirë ata me kapital të huaj, u shfaqën në treg. Një pikë kthese për sektorin bankar në Shqipëri mund të konsiderohet privatizimi i Bankës së Kursimeve në vitin 2004, duke çuar në një liberalizim të mëtejshëm të tregut, rritjen e konkurrencës dhe vendosjen e një standardi të ri për aktorët e tjerë të tregut. Mbështetur edhe nga rritja e fortë dhe e qëndrueshme ekonomike në vitet 2000, sektori përjetoj një periudhë zgjerimi të shpejtë të demonstruar nga rritja e lartë e kreditimit, financuar në një masë të madhe nga huamarrja e huaj. Ndërmjet viteve 2001 dhe 2007, kredia bankare ndaj PBB-së u rrit nga 5% në 30%, krahas një rritjeje të lartë e të qëndrueshme të PBB-së prej rreth 6% (Figurë 1).

---

<sup>5</sup> G. Sejko G, E. Dushku (2018).

Figurë 1. Rritja reale e PBB-së dhe kredia bankare ndaj PBB-së, 2001-2021




Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorëve.

Kriza financiare botërore goditi Shqipërinë në mesin e vitit 2009 nëpërmjet rënies së kërkesës së jashtme dhe përkeqësimit të kushteve financiare, duke çuar gjithashtu në një nënçmim të fortë të monedhës vendase. Aktivitetit ekonomik në vend u ngadalësua dhe kreditë me probleme (në vijim RKP-të) filluan të rriten me shpejtësi, duke arritur në pothuajse 25% në fund të vitit 2014.

Një nga faktorët e këtij përkeqësimi të cilësisë së portofolit të kredisë bankare ishin kreditë e dhëna në valutë, si për korporatat ashtu edhe për individët, të cilat ishin më të kërkuara gjatë viteve 2000 për shkak të normave të tyre të ulëta të interesit në krahasim me kreditë në Lek, por që shfaqën problematika në shlyerje në periudhat e nënçmimit të monedhës vendase (Figurë 2).


Figurë 2. Kredia në valutë ndaj totalit të kredive dhe raporti i kredive me probleme, 2001-2021



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autorëve.

Për rrjedhojë, vëmendja e autoritetit mbikëqyrës u zhvendos më së shumti drejt zgjidhjes së situatës të kredive me probleme. Duke filluar nga viti 2013 e në vazhdim, Banka e Shqipërisë ndërmoi një sërë masash, përfshirë fshirjen e detyrueshme nga bilanci i bankave, të kredive me probleme si dhe rishikimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ me synimin për të ulur nivelin e tyre dhe për t'i bërë bankat më elastike në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të financimit. Pavarësisht përkeqësimit të cilësisë së kredisë gjatë dekadës së fundit, sektori bankar është karakterizuar gjithmonë nga nivele të mira kapitalizimi (Figurë 3), megjithëse raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ndryshon ndjeshëm nga njëra bankë në tjetrën.

Figurë 3. Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe Kapitali Bazë i Nivelit të Parë, 2001-2021.



Burimi: Banka e Shqipërisë, lloqaritje të autorëve.

Pas krizës financiare botërore, sektori bankar shqiptar filloi rrugëtimin e tij të konsolidimit. Këto vite reflektuan një ulje të ekspozimit të disa bankave të huaja në Shqipëri, ulje të mbështetjes në financimin e huaj dhe disa bashkime e blerje në këtë sektor. Banka e Shqipërisë mbikëqyri me sukses procesin e konsolidimit të sektorit bankar gjatë këtyre viteve, i cili u karakterizua jo vetëm nga rënia e numrit të bankave të nivelit të dytë, por edhe nga hyrja e lojtarëve të rinj dhe rritja e konkurrencës në tregun e brendshëm.

Për sa i përket kuadrit rregullativ, Banka e Shqipërisë si autoritet rregullator dhe mbikëqyrës, ka përafëruar vazhdimisht kuadrin e saj me parimet dhe standardet e Bazelit dhe me ligjet e BE-së. Në vitin 1999, ajo prezantoi kërkesat për kapital bazuar në Bazel I, me raportin minimal të mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) të vendosur në nivelin 12%, për të mbuluar dy lloje rreziqesh: rrezikun e kredisë dhe rrezikun e tregut. Në vitin 2013 (me rregulloren 48/2013 "Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit"), zbatoi shtyllat kryesore të Bazelit II, si metodën standarde (STA) për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e tregut, si dhe metodën e treguesit të thjeshtë, atë standarde dhe qasjen e treguesit alternativ për rrezikun operacional, ku minimum i kërkuar për RMK-në mbeti 12%. Ndryshe nga standardet e Bazelit II, Banka e Shqipërisë ka zgjedhur

të mos përfshijë në kuadrin e saj rregullativ qasjen e bazuar në vlerësimet e brendshme (IRB) për rrezikun e kredisë, duke gjykuar nga këndvështrimi i kompleksitetit të saj, nevojave për të dhëna dhe nivelit të zhvillimit të sektori bankar. Gjithsesi, ajo ka përfshirë disa ndryshime kundrejt skemës së peshimit të rrezikut sipas qasjes standarde të Bazelit, duke kërkuar një peshë më të lartë rreziku për ekspozimet në valutë të huaj. Rregullorja e mjaftueshmërisë së kapitalit trajton metodat për llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë së kundërpartisë (për ekspozimet në librin e tregtueshëm ose jo), teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë (në formën e mbrojtjes së kredisë së financuar dhe të pafinancuar) dhe trajtimin e ekspozimeve të titullzimit, megjithëse ekspozime të tilla janë pothuajse jo të qenësishme në Shqipëri.

Në vitin 2014, Banka e Shqipërisë miratoi rregulloren “Për kapitalin rregullator të bankës”, e cila përcakton strukturën, përbërësit dhe mënyrën e llogaritjes së kapitalit rregullator të bankave dhe përcakton gjithashtu raportet minimale të kapitalit (raporti i kapitalit bazë të nivelit të parë, raporti i kapitalit të nivelit 1 të parë, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit). Rregullorja merr në konsideratë kërkesat e Bazel III që parashikojnë përkatësisht elementët e kapitalit rregullator; elementët e kapitalit bazë të nNivelit të parë, të kapitalit shtesë të nivelit 1 të parë dhe elementë të kapitalit të nivelit të dytë; zbritjet dhe rregullimet nga kapitali bazë i nivelit të parë dhe kapitali rregullator në përgjithësi; si dhe nivelet e raporteve të kapitalit, të cilët në fund të vitit 2021 janë si më poshtë: 12% për raportin minimal të mjaftueshmërisë së kapitalit, 9% për raportin minimal i kapitalit të nivelit të parë dhe 6.75% për raportin minimal të kapitalit bazë të nivelit të parë.

Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, për të qenë i pranueshëm si element i kapitalit rregullator, kapitali i nivelit të dytë kufizohet në një të tretën e kapitalit të nivelit të parë, një kërkesë në përputhje me kërkesat e BE-së për mjaftueshmërinë e kapitalit. Në të njëjtin vit, Banka e Shqipërisë ka transpozuar edhe kërkesat e Bazelit për ekspozimet e mëdha, duke miratuar rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave” dhe duke e ndryshuar më vonë në vitin 2020, për të reflektuar kërkesat e përditësuara të BE-së mbi mjaftueshmërinë e kapitalit (EU CRR)<sup>6</sup>.

---

<sup>6</sup> EU Capital Requirement Regulation (CRR).

Rregullorja e mjaftueshmërisë së kapitalit është rishikuar vazhdimisht që nga viti 2013/2014 për ta përafuar atë me rregulloren në zhvillim të kërkesave për kapital (CRR/CRD<sup>7</sup>) në BE, duke reflektuar zbatimin e Bazel III. Në kuadër të kërkesave të Shtyllës II, Banka e Shqipërisë miratoi në vitin 2017 udhëzimin “për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit (ICAAP), i cili synon përafrimin e praktikave mbikëqyrëse me parimet e Bazelit dhe ligjin e BE-së. Procesi i vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit, i cili kryhet në mënyrë të pavarur nga banka, siguron vlerësimin e niveleve aktuale dhe të ardhshme të mjaftueshmërisë së kapitalit, bazuar në strategjinë dhe profilin e saj të rrezikut. Në të njëjtën kohë, ai i lejon Bankës së Shqipërisë të vendosë shtesa kapitali sipas Shtyllës II, të cilat banka duhet t’i përmbushë mbi mjaftueshmërinë minimale të kapitalit<sup>8</sup>. Këto shtesa të Shtyllës II përdoren në mënyrë aktive, duke marrë vlera nga 0% deri në 3%.

Në fushën e mjaftueshmërisë së kapitalit, një hap i rëndësishëm në zbatimin e veçorive të reja nga Bazel III ka qenë vendosja dhe zbatimi shtesave makroprudenciale të kapitalit. Në vitin 2019, Banka e Shqipërisë miratoi rregulloren “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”, me vendimin nr. 41, datë 05.06.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë (në vijim, rregullorja 41/2019). Rregullorja 41/2019 kërkonte që bankat të ndërtonin shtesën konservuese të kapitalit (KONS), shtesën kundërciklike të kapitalit (KUNC) dhe shtesën për bankat me rëndësi sistemike (SIST)<sup>9</sup>.

---

<sup>7</sup> *EU Capital Requirements Directive (CDR).*

<sup>8</sup> *Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka hartuar edhe një dokument për “Procesin e rishikimit dhe vlerësimit mbikëqyrës” (SREP), i cili në periudhën 2021/2022 ishte në fazë prove dhe kalibrimi. Duke marrë parasysh objektivin më të gjerë të përafrimit të kuadrit të tij rregullator dhe mbikëqyrës me atë të BE-së, dokumenti është përgatitur bazuar në Udhëzimet për Procedurat dhe Metodologjitë e Përbashkëta për SREP-in të nxjerra nga Autoriteti Bankar Evropian (EBA).*

<sup>9</sup> *Për shtesën konservuese të kapitalit (KONS), rregullorja 41/2019 përcakton në nenin 10, paragrafi (1), se vlera që duhet të përmbushet dhe mbahet nga secila prej bankave për vitin 2023 është 2.0%; për shtesën kundërciklike të kapitalit (KUNC), rregullorja përcakton në nenin 12, pika (3), se norma e aplikuar duhet të shpallet rregullisht nga Banka e Shqipërisë dhe mund të lëvizë nga 0% në 2.5%; niveli aktual (AKUNC) për Shqipërinë është 0%, për t'u përmbushur duke filluar nga tetori 2023; dhe për shtesën e kapitalit të bankave me rëndësi sistemike (SIST), e cila është e ndryshme sipas institucioneve, rregullorja parashikon në nenin 14 paragrafi (b) se vlerat mund të jenë deri në 1.5% për vitin 2023.*

Miratimi i rregullores "Për raportin e levës financiare të bankave" në vitin 2020 përfaqëson një tjetër përafrim me rregulloret e Bazelit III. Ajo përputhet pjesërisht me Bazel III dhe kuadrin rregullativ të BE-së, duke marrë në konsideratë karakteristikat e tregut vendas dhe kompleksitetin e tij. Raporti minimal i levës financiare të kërkuar është vendosur në masën 5.75%, ndryshe nga standardi i Bazelit prej 3%. Vendosja e këtij kufiri më të lartë është paraprirë nga një analizë sasiore e Banka së Shqipërisë, mbështetur në metodologjinë e publikuar në një material studimor të BIS "Mbi kalibrimin e raportit të levës financiare". Ky kufi më i lartë është gjithashtu në përputhje me normën më të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 12%, krahasuar me 8% në Bazel III, përshtatur me stadin e zhvillimit të tregut bankar shqiptar.



### **3. USHTRIMI I PROVËS SË REZISTENCËS NË BANKËN E SHQIPËRISË GJATË PERIUdhËS 2007-2021**

Ushtrimet e provës së rezistencës shërbejnë për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar ndaj goditjeve ekstreme por të besueshme dhe përdoren shpesh nga pothuajse të gjitha bankat qendrore (Budnik et al. 2020; Dent et al. 2016). Goditjet zakonisht shprehen si goditje makroekonomike (një rënie/tkurrije e theksuar e PBB-së, nënçmim i monedhës vendase, rritje e normave të interesit në treg, etj.) që ndikojnë në bilancet e bankave. Ky ndikim matet me ndihmën e modeleve satelitore (ose supozimeve të tjera) që transpozojnë goditjet makroekonomike në bilancin e bankave dhe në zërat kryesorë të llogarisë së fitim-humbjes (siç është rritja e kredive me probleme dhe provigjionimi më i lartë i tyre, rënia e të ardhurave neto nga interesi etj.).

Dy tipare tipike të ushtrimeve të tilla të provës së rezistencës janë: (i) është një ushtrim i kryer nga banka qendrore (ose institucioni mbikëqyrës) sipas qasjes “nga lart-poshtë” për të gjitha bankat e sektorit, duke përdorur të dhënat e disponueshme nga raportimi i rregullt; dhe (ii) goditjet makroekonomike zakonisht ndërthuren në një skenar makroekonomik, i cili siguron që goditjet janë konsistente dhe të besueshme. Skenarët shpesh përgatiten me ndihmën e modeleve makroekonomike dhe mbështeten mbi një narrativë të fortë të zhvillimeve të pafavorshme ekonomike.

Banka e Shqipërisë kryen këtë ushtrim që nga viti 2007 me një frekuencë vjetore dhe që nga viti 2010 me një frekuencë gjashtëmujore. Ky ushtrim kryhet nga Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe një përmbledhje e rezultateve të përfuara në rang sektori bankar dhe grupe bankash, publikohet në Raportin gjashtëmujor të Stabilitetit Financiar.

Qasja makroprudenciale ndryshon nga të ashtuquajturat ushtrime mikroprudenciale të provës së rezistencës, të cilat zakonisht kryhen sipas një qasje “nga poshtë-lart”, ku autoriteti rregullator përcakton skenarët dhe goditjet, si dhe supozimet e kufizimet kryesore, por

llogaritjet e ndikimit të tyre në bilanc kryhen nga vetë bankat (BCBS 2017, 2018). Këto ushtrime janë më të sakta pasi bankat kanë informacion më të detajuar për huamarrësit individualë dhe ndjeshmërinë e tyre ndaj goditjeve ekonomike. Megjithatë, ato janë më të kushtueshme dhe kërkojnë më shumë kohë, ndaj për këtë arsye kryhen më rrallë e kryesisht me një numër të kufizuar bankash (zakonisht më të mëdhatë). Këto ushtrime mikroprudenciale të provës rezistencës, të bazuara në qasjen "nga poshtë-lart", kryhen nga Banka e Shqipërisë që prej vitit 2013 dhe vetëm për banka të përzgjedhura. Ato bazohen në skenarët e ushtrimit makroprudencial të provës së rezistencës, por në këtë ushtrim marrin pjesë vetëm 6 bankat më të mëdha bazuar në madhësinë e aktiveve të tyre. Këto ushtrime kanë një vlerë të shtuar nga këndvështrimi mbikëqyrës, pasi rezultatet përdoren nga mbikëqyrja në procesin e rishikimit dhe vlerësimit mbikëqyrës.

Gjatë viteve 2007-2013, ushtrimet e provës së rezistencës përdornin një kuadër shumë të thjeshtë. Fillimisht, ato u ndërtuan në sajë të asistencës teknike të FMN-së në kuadër të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar 2005 (FSAP) për Shqipërinë, duke u mbështetur vetëm në analizën e ndjeshmërisë. Pas vitit 2009, këto ushtrime u përmirësuan duke ndjekur metodën e FMN-së për zhvillimin e koordinuar të ushtrimeve të provës së rezistencës në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore. Departamenti i Stabilitetit Financiar u fokusua në të gjithë sektorin bankar dhe zbatoi analiza të ndjeshmërisë dhe të skenarëve.

Këto qasje u zëvendësuan nga një kornizë më komplekse në vitin 2013 me rastin e misionit të radhës FSAP të FMN-së në Shqipëri. Ushtrimi i provës së rezistencës filloi të përdorë skenarë të qartë makroekonomikë të gjeneruar nga modeli makroekonomik i Bankës së Shqipërisë MEAM, me një skenar bazë që mbështetej në parashikimin zyrtar makroekonomik dhe dy skenarë të pafavorshëm që ndryshonin nga njëri-tjetri për sa i përket intensitetit të goditjeve. Variablat kyç mbi të cilët do të përcaktoheshin skenarët ishin: rritja reale e PBB-së, kursi i këmbimit të monedhës vendase ndaj euros dhe dollarit amerikan, normat e interesit dhe rritja e përgjithshme e kredisë. Projektionet përgatiteshin për dy vitet e ardhshme.

Variablat makroekonomikë përfshiheshin më pas në dy modele satelitore të rrezikut të kredisë - një për kreditë në monedhë vendase dhe një për kreditë në valutë të huaj - për të gjeneruar projeksione të raportit të kredive me probleme. Rreziku i kredisë është rreziku më i rëndësishëm në sektorin bankar shqiptar.

Duke patur parasysh peshën e madhe të kredive në valutë në totalin e huadhënies (65.0% e totalit të tepricës së kredisë në vitin 2013, nga të cilat 50% ishte për huamarrësit e pambrojtur), ushtrimi i provës së rezistencës duhej të kapte edhe të ashtuquajturin rrezik indirekt të nxitur nga kredia në valutë. Pra, rreziku që huamarrësit mund të mos jenë në gjendje të shlyejnë kreditë e tyre në valutë në periudhat e një nënçmimi të madh të monedhës kryesore në të cilën ata zakonisht marrin të ardhurat e tyre.

Siç tregohet nga evidenca<sup>10</sup>, kreditimi në valutë u nxit kryesisht nga disponueshmëria e depozitave në monedhë të huaj të sektorit bankar dhe në rrethana të tilla si diferenca më të larta të normave të interesit, luhatshmëria e inflacionit dhe luhatshmëria më e ulët e kursit të këmbimit. Kjo është arsyeja pse lidhja midis variablave makroekonomikë dhe raportit të kredive me probleme u vlerësua veçmas për kreditë në monedhë vendase dhe ato në valutë.

Modelet satelitore të rrezikut të kredisë u vlerësuan përmes një modeli të thjeshtë OLS dhe seritë kohore përfshinin të dhëna tremujore të periudhës T1 2002-T3 2012. Variablat e varur futeshin përkatësisht si ndryshime të raportit të kredive me probleme të sektorit bankar për portofolin në monedhën vendase dhe për atë në valutë, variablat shpjegues përfshinin faktorët makroekonomikë tradicionalë që ndikojnë zakonisht në rrezikun e kredisë, si p.sh. rritja ekonomike (PBB), kursi i këmbimit (Lek/Usd dhe Lek/Eur) dhe normat e interesit (euribor 3-mujor dhe bono thesari 12-mujore). Specifikimet e vlerësuar të përdorura gjatë periudhës 2013-2021 janë si më poshtë:

---

<sup>10</sup> G. Shijaku (2016): "Kreditimi në valutë në Shqipëri", Material studimor i BSH.

Modeli i kredive me probleme për portofolin në valutë:

$$D(NPL\_RATIO\_FOR) = 0.0021 - 0.0186 * DLOG (GDP (-2)) + 0.06 * DLOG (ALL\_USD (-1)) + 0.19 * DLOG (ALL\_EURO) + 0.0019 * EUR\_3 * DUMMY\_08$$

$R^2$ -i përshtatur = 0.36, Durbin-Watson = 2.09

Ku: NPL\_RATIO\_FOR - raporti i kredive me probleme në valutë;  
GDP - PBB tremujore e vlerësuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT);  
ALL\_USD - kursi i këmbimit Lek kundrejt dollarit amerikan;  
ALL\_EURO - kursi i këmbimit Lek kundrejt Euros;  
EUR\_3 - EURIBOR 3 mujor;  
DUMMY\_08 - variabli dummy është "0" për periudhën 2002T1-2008T2 dhe "1" për periudhën 2008T3-2012T3.

Variabli DNPL\_RATIO\_FOR nuk shfaqti sjellje autoregresive pasi asnjë nga vonesat kohore nuk ishte statistikisht e rëndësishme. Të gjithë koeficientët e vlerësuar kishin një shenjë të pritshme, ishin statistikisht të rëndësishëm në një interval besimi prej 10% dhe testet e stabilitetit konfirmuan se ata ishin të qëndrueshëm përgjatë kohës. Rezultatet e vlerësimit tregojnë se nënçmimi i lekut kundrejt euros ka një ndikim mjaft të rëndësishëm në raportin e kredive me problem në valutë, ku një nënçmim prej 10% do të rriste raportin e kredive me problem në valutë me 1.9 pp brenda një tremujori, duke konfirmuar ekzistencën e rrezikut të tërthortë të kredisë i shkaktuar nga portofolit në monedhë të huaj.

Modeli i kredive me probleme për portofolin në monedhë vendase:

$$D(NPL\_RATIO\_ALL) = 0.0029 + 0.33 * D(NPL\_RATIO\_LEK (-1)) - 0.013 * DLOG (GDP) + 0.0029 * D(TB\_12 (-2)) + 0.077 * DLOG (LEK\_EURO (-3))$$

$R^2$ -i përshtatur = 0.28, Durbin-Watson = 1.9

Ku: NPL\_RATIO\_ALL - raporti i kredive me probleme në monedhën vendase;  
GDP - PBB tremujore (të dhëna të INSTAT, Instituti i Statistikave);  
TB\_12 - norma e interesit për bonot e thesarit 12-mujore;  
ALL\_EURO - kursi i këmbimit të Lek kundrejt Euros.

Për të shpjeguar ecurinë e kredive me probleme në monedhën vendase, janë përfshirë të njëjtat variabla si për kreditë me probleme në valutë të huaj, me përjashtim të normave të interesit, ku në vend të Euriborit 3-mujor (që është i rëndësishëm për kreditë në valutë) u përdorën bonot e thesarit 12-mujore dhe u përfshi vetëm një kurs këmbimi (Lek/Eur) si përafrues për rrezikun dhe pasigurinë e përgjithshme (leku zakonisht nënçmohet në kohë pasigurie më të lartë ekonomike). Të gjithë koeficientët e vlerësuar kishin një shenjë të pritishtme, ishin statistikisht të rëndësishëm në një interval besimi prej 10% dhe testet e stabilitetit konfirmuan se ata ishin të qëndrueshëm përgjatë kohës. Në ndryshim nga modeli i raportit të kredive me probleme në monedhën vendase, këtu duhej përfshirë termi autoregresiv, pasi RKP-ja në monedhën vendase shfaqte sjellje autoregresive. Fuqia shpjeguese e modelit është 28%, disi më e ulët se në rastin e ekuacionit të monedhës së huaj.

Megjithëse u përdorën dy modele të rrezikut të kredisë, kreditë me probleme të bankave individuale u projektuan duke përdorur një projeksion agregat të RKP-ve për totalin e portofolit (d.m.th. pa ndarje sipas monedhës ose sipas sektorëve). Ky projeksionu ndërtohet si një mesatare e peshuar e dy projeksioneve të veçanta të RKP-ve sipas monedhës, ku pesha specifike jepet sipas peshës që zinte kredia në monedhën vendase dhe ajo në valutë ndaj portofolit të kredisë në total të sektorit bankar. RKP-të e rritura më pas do të provigjionoheshin (me normat fillestare të provigjionimit mesatar të RKP-së specifike për secilën bankë), duke gjeneruar humbje nga portofoli i kredisë dhe duke ndikuar mbi fitimin dhe humbjen e bankave dhe mbi kapitalin rregullator.

Krahas rrezikut të kredisë, në provën e rezistencës është përfshirë edhe rreziku i normës së interesit dhe rreziku (i drejtpërdrejtë) i kursit të këmbimit. Bankat përballen me rrezikun e normës së interesit, pasi aktivet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit nuk përputhen. Një rritje e normës së interesit ndikon ndryshe në vlerën e aktiveve dhe vlerën e detyrimeve, si dhe ndikon në të ardhurat neto nga interesi. Gjithashtu, duke pasur parasysh regjimin e lirë të kursit të këmbimit dhe ekzistencën e ekspozimeve dhe financimit në valutë, bankat në Shqipëri janë gjithashtu të ekspozuara edhe ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për shkak të ndryshimeve në vlerën

e zërave të shprehur në valutë gjatë periudhave me luhatshmëri në ecurinë e kursit të këmbimit.

Për të kapur ndikimin e ndryshimeve në normat e interesit që ishin pjesë e skenarit (euribor 3-mujor dhe norma e bonove të thesarit 12-mujore), modeli i hendekut të riçimit u përdor veçmas për zërat në valutë dhe në monedhën vendase, për të vlerësuar efektin e ndryshimit në normën e interesit mbi të ardhurat neto nga interesi. Në mënyrë tipike, duke pasur parasysh hendekun negativ të riçimit të bankave (d.m.th. nivel më i lartë i detyrimeve afatshkurtra si depozitat pa afat në krahasim me më shumë zëra të aktiveve afatgjata si kreditë), një rritje e normave të interesit do të çonte në ulje të të ardhurave neto nga interesi, duke reflektuar nevojën për riçimin e detyrimeve më shpejt sesa të aktiveve. Gjithashtu, normat e interesit kanë ndikuar edhe në vlerën e obligacioneve të mbajtura nga bankat, ku ndikimi është llogaritur duke përdorur kohëzgjatjen e modifikuar (modified duration) të portofolit të obligacioneve të bankave.


Rreziku i kursit të këmbimit (rreziku i drejtpërdrejtë) u vlerësua duke përdorur informacionin për pozicionin e hapur neto në valutë në Eur dhe Usd, i cili, kur shumëzohet me ndryshimin në kursin e këmbimit, do të gjeneronte të ardhura ose humbje nga rivlerësimi.

Ndikimi përfundimtar i të katërt faktorëve të lartpërmenduar - humbjet nga portofoli i kredisë, ndikimi në të ardhurat neto nga interesi, rivlerësimi i obligacioneve dhe rivlerësimi nga kursi i këmbimit - u zbritën nga kapitali rregullator fillestar dhe ekspozimet e peshuara me rrezikun në secilin prej dy viteve të horizontit kohor të ushtrimit të provës së rezistencës, duke gjeneruar një projeksion të raportit të përgjithshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit për dy fundvitet e ardhshme për secilën bankë. Në rastet kur një apo disa banka ishin nën minimumin rregullator, u llogaritën shtesat e kapitalit që do të nevojiteshin për t'i sjellë ato banka të paktën në minimumin rregullator.

Në vijim paraqitet përdorimi i kësaj metodologjie me skenarë ilustrues dhe rezultate të gjashtëmujorit të parë të vitit 2019 të publikuara në atë kohë në Raportin e Stabilitetit Financiar.

Ushtrimi i provës së rezistencës vlerëson qëndrueshmërinë e sektorit bankar në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit për pjesën e mbetur të vitit 2019 dhe për vitin 2020. Vlerësimi i ndikimit të skenarëve makroekonomikë në situatën financiare të sektorit bankar përjashton mundësinë e rritjes së kapitalit të paguar gjatë periudhës. Ushtrimi kryhet duke aplikuar tre skenarë: skenarin bazë, skenarin e moderuar dhe skenarin e rënduar (Figura 4).

Figurë 4. Skenarët makroekonomikë të përdorur në gjashtëmuorin e parë 2019



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Skenari bazë supozon një rritje ekonomike pozitive dhe me pririje rritëse përgjatë harkut kohor të zhvillimit të ushtrimit të provës së rezistencës. Në këtë skenar, rritja ekonomike shoqërohet me norma rritëjeje pozitive të kreditimit, mbështetur gjithashtu në përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së portofolit të kredisë deri në fund të vitit 2020. Në skenarin e moderuar, rritja ekonomike mbetet pozitive përgjatë të dy viteve të ushtrimit, por dukshëm më e ulët kundrejt vlerave të skenarit bazë; ndërsa në skenarin e rënduar është supozuar një rritje e ekonomisë për pjesën e mbetur të vitit 2019 dhe një tkurrje e ndjeshme e saj për vitin 2020.

Supozimeve për ecurinë ekonomike në të dy skenarët e pafavorshëm i bashkëlidhen edhe supozimet përkatëse për një nënçmim të kursit të këmbimit të monedhës vendase, një rritje të

normës së interesit dhe përgjysmim të ritmit të kreditimit deri në ndalimin e tij. Këto zhvillime, krahas vlerave në rënie të vëllimit të kredive të fshira, reflektohen në një përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredisë. Konkretisht, raporti i kredive me probleme përkeqësohet deri në fund të vitit 2020 deri në 6.3 pikë përqindjeje (skenari i moderuar) dhe 14.8 pikë përqindjeje (skenari i rënduar) ndaj vlerave faktike të muajit qershor 2019. Këto supozime ndikojnë në një rënie të vlerës së treguesve të kapitalizimit të sektorit bankar, më e ndjeshme për grupe të veçanta bankash dhe kryesisht gjatë vitit të dytë të ushtrimit.

Për sa i përket mjaftueshmërisë së kapitalit, rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës tregojnë se në skenarin bazë, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) të sektorit bankar paraqitet i qëndrueshëm dhe në nivele të krahasueshme me vlerat faktike të muajit qershor 2019. Në terma konkretë, ky raport arrin në 18.0% në fund të vitit 2019 dhe ngjitet në nivelin e rreth 18.3% në fund të vitit 2020. Ky zhvillim reflekton supozimin mbi ritmin e rritjes ekonomike, rritjen pozitive të kreditimit të ekonomisë, përmirësimin e mëtejshëm të portofolit të kredive me probleme dhe ecurinë e favorshme të kursit të këmbimit. Nga ana tjetër, ecuria e supozuar e normave të interesit (shih grafikun e mësipërm), nisur nga struktura e "aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit deri në 12 muaj" të sektorit bankar, ka dhënë ndikim në kahe të kundërta. Konkretisht, ajo ndikoi në rënien e RMK-së së sektorit gjatë vitit të parë të ushtrimit dhe në rritjen e tij gjatë vitit të dytë. Zhvillimet sipas grupeve bankare regjistrojnë nivele të larta kapitali, dukshëm mbi nivelin minimal të kërkuar nga kuadri rregullativ.

Në skenarin e moderuar, RMK-ja e sektorit bankar ulët në një nivel prej 13.3% në fund të vitit 2019 dhe 11.4% në fund të vitit 2020. Kjo normë ndikohet nga supozimet për një normë të ulët rritjeje të aktivitetit ekonomik, përgjysmim në ritmin rritës së kredisë, nënçmim të monedhës vendase, rritje të raportit të kredisë me probleme – në vijim të një niveli më të ulët të fshirjeve të kredive të humbura nga bilancet e bankave - dhe humbje nga portofoli në tituj. Bazuar edhe në supozimet e mësipërme dhe rezultatet e përfuara, zhvillimet në banka të veçanta evidentojnë nevojën për injektim kapitali gjatë periudhës kohore dyvjeçare. Numri i bankave




që paraqiten të nënkapitalizuara shkon deri në gjashtë në fund të periudhës, duke përbërë rreth 70% të aktiveve të sektorit. Në këtë rast nevoja për kapital shtesë shkon deri në rreth 10.6 miliardë lekë (më pak se 1% e PBB-së).

Së fundi, në skenarin e rënduar, RMK-ja e sektorit bankar bie në 11.2% në fund të vitit 2019 dhe në 8.4% në fund të vitit 2020, ndikuar nga supozimet ndjeshëm më të rënuara që përfshin ky skenar. Numri i bankave që bien në nënkapitalizim rritet në tetë dhe këto banka zënë rreth dy të tretat e aktiveve të sektorit. Zhvillimet makroekonomike ekstreme që përmban skenari, krahas ndalimit të kreditimit të ekonomisë, ndikojnë në përkeqësimin e ndjeshëm të cilësisë së kredisë. Gjithashtu, edhe ky skenar supozon humbje në portofolin e titujve dhe rritje të ekspozimit ndaj rrezikut operacional. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë janë rreth dy herë më të larta (rreth 1.3% e PBB-së).

Nisur nga sa më sipër, por edhe nga një këndvështrim krahasues me periudhën paraardhëse, rezultatet treguan për një ndjeshmëri më të lartë të sektorit bankar ndaj zhvillimeve të supozuara ekonomike dhe financiare, duke reflektuar nivele më të ulëta të RMK-së në nivel sektori dhe në banka veçanta. Megjithatë, nevojat për kapital u konsideruan të përballeshme nga sektori bankar.

Figurë 5. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit sipas skenarëve të provës së rezistencës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 4. METODOLOGJIA E RE E USHTRIMIT TË PROVËS SË REZISTENCËS

Në vitin 2021, Banka e Shqipërisë rishikoi metodologjinë e ushtrimit të provës së rezistencës, falë asistencës së ofruar për bankat qendrore nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO). Metodologjia e re adresoi mangësitë e metodologjisë së mëparshme të provës së rezistencës në vijim të zhvillimeve në sektorin bankar dhe në kuadrin rregullativ përkatës. Mangësitë kryesore të metodologjisë së mëparshme, të cilat u evidentuan nga ekspertët e Bankës së Shqipërisë në bashkëpunim me ekspertin e SECO-s, renditen më poshtë.

- Modelet ekzistuese të rrezikut të kredisë sipas monedhës nuk ofronin më projeksione të besueshme të nivelit të kredive me probleme. Hyrja në fuqi e vendimit mbi fshirjen nga bilanci të kredive të humbura<sup>11</sup>, evidentoi nevojën emergjente të rishikimit të këtyre projeksioneve të cilat tashmë do të duhej të konsideroheshin në mënyrë eksplicite.
- Projektionet në kuadër të rrezikut të kredisë nuk merrnin në konsideratë goditje të supozuara shtesë për portofolin e kredive me probleme, duke nënvlerësuar potencialisht humbjet nga portofoli i kredisë (p.sh.: migrim i kredive me probleme drejt klasave më pak cilësore, për të cilat do të duhej të kërkohej një normë më e lartë e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë). Për më tepër, ekzistonin/vëreheshin mangësi edhe përsa i përket prjekcioneve mbi portofolin e kredisë të klasifikuar në klasën “në ndjekje” (tipikisht me 30-90 ditë vonesë), të cilat pavarësisht se janë pjesë e kredive cilësore kërkojnë një mbulim më të lartë në terma të fondeve rezervë për humbjet nga kreditë.
- Metodologjia ekzistuese nuk ofronte mundësi për goditje specifike mbi cilësinë e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë (p.sh. goditje shtesë në portofolin e kredive me probleme për sektorin e ndërtimit, sektorin e tregtisë, sektorin e aktiveve jofinanciare (kredi hipotekare), etj..
- Harku kohor dyvjeçar (i cili rezultoi në një hark kohor prej

---

<sup>11</sup> Vendim nr. 50, datë 30.03.2016 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

vetëm 1.5 vitesh, kur provat e rezistencës kryheshin me të dhënat e mesit të vitit) u konsiderua si i pamjaftueshëm për të pasqyruar plotësisht ndikimin e vonuar të zhvillimeve makroekonomike në bilancet e bankave.

- Metodologjia nuk përfshinte në mënyrë të plotë dhe të qartë një projeksion të të ardhurave para goditjes (para provigjionimit), duke mbivlerësuar ndikimin e goditjeve të rrezikut të kredisë dhe të rrezikut të tregut në kapitalin rregullator.
- Kuadri rregullativ i kapitalit i ndryshuar (me përfshirjen e Shtyllës 2 dhe shtesave të ndryshme të kapitalit) duhej rishikuar për të përfshirë llojet e ndryshme të minimeve rregullative (me/pa shtesa të kapitalit).

Për të përballuar sfidat e sipërpërmendura, u ndërtua një kuadër krejtësisht i ri për ushtrimin e provës së rezistencës. Ushtrimi shtrihet përgjatë një harku kohor të zgjeruar deri në tre vjet, ku projeksionet u referohen gjithnjë tre fundviteve më të afërta, pavarësisht tremujorit në të cilin kryhet ushtrimi. Projeksionet përgatiten për tre skenarë makroekonomikë (skenari bazë, skenari i moderuar dhe ai i rënduar), të cilët mund të kalibrohen bazuar mbi supozime specifike për variablat kyçë makroekonomikë, si: rritja reale e PBB-së, norma e papunësisë, niveli i normave të interesit, kursi i këmbimit, çmimet e banesave, si dhe rritja e kredisë për biznese dhe individë, me një frekuencë tremujore për tre vitet e ardhshme. Skenarët makroekonomikë përgatiten nga makromodeli i Departamentit të Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë dhe diskutohen gjerësisht përpara se të përdoren për ushtrimin e provës së rezistencës.

## 4.1 Rreziku i kredisë

Dy modele të reja satelitore u ndërtuan për të vlerësuar rrezikun e kredisë, por në vend të ndërtimit të modeleve të kredive me probleme sipas monedhës, u ndërtua dy modele të veçanta, një për rrezikun e kredisë për korporatat jofinanciare (biznese) dhe një për rrezikun e kredisë për individët. Në këtë mënyrë, ka një përputhje më të mirë me praktikën më të mirë dhe mund të evidentohen nivele të ndryshme ndjeshmërie ndaj zhvillimeve makroekonomike për këto dy segmente të tregut. Të dy modelet vlerësojnë raportin e kredive

me probleme (me një transformim logaritmik) si variabli i varur dhe faktorët kryesorë makrofinanciarë sipas skenarëve specifikë (rritja e PBB-së dhe norma e interesit për modelin e kredisë për biznese; ,norma e papunësisë dhe norma e interesit për modelin e kredisë për individë) si variabla të krahut të djathtë, duke lejuar përfshirjen e tyre për të njëjtën periudhë kohore dhe me vonesë kohore, si dhe një term autoregresiv (variabël i varur me vonesë kohore), i cili kontrollon persistencën e fortë të variablit të varur.

Specifikimi përfundimtar i modelit mbi raportin e kredive me probleme (RKP) për bizneset (me koeficientë të rumbullakosur) është:

$$RKP\_i\_transformuar(t) = -0,12 + 0,95 * RKP\_i\_transformuar(t-1) - 1,5 * PBB\_rritje(t) + 2,01 * normë\_interesi\_12M$$

Specifikimi përfundimtar i modelit mbi RKP për individët (me koeficientë të rumbullakosur) është:

$$RKP\_i\_transformuar(t) = -0,17 + 0,96 * RKP\_i\_transformuar(t-1) + 1,52 * diferenca\ midis\ normës\ mesatare\ të\ papunësisë\ së\ 4\ tremujorëve\ të\ fundit\ dhe\ 4\ tremujorëve\ të\ mëparshëm + 2,01 * norma\_interesi\_12M$$

Portofolet e kredisë së bankave ndahen në 15 segmente të ndryshme kredie (13 segmente i përkasin portofolit të kredisë për biznes, sipas sektorëve të ekonomisë dhe 2 segmente i përkasin portofolit të kredisë për individë, sipas qëllimit të kredisë, Tabela 1). Si pjesë e tre skenarëve makroekonomikë, supozimet e rritjes së portofolit të kredisë për bizneset dhe individët zbatohen për të gjitha bankat dhe për të gjitha segmentet në mënyrë uniforme. Raportet e kredive me probleme për çdo bankë sipas çdo segmenti, të cilat aplikohen në shumat bruto të tepricës së kredisë të ndryshueshme në kohë, gjenerohen duke aplikuar ndryshimin absolut të nënkuptuar nga modeli i raportit të kredive të secilit sektor në raportet fillestare të kredive me probleme për çdo bankë dhe për çdo segment. Kjo nënkupton që edhe segmentet që kanë një raport të kredive me probleme në nivelin 0%, goditen në rast të një shtese stres. . Për më tepër, ekziston mundësia për të ofruar goditje shtese ad-hoc mbi nivelin e raportit të kredive me probleme për një sektor të caktuar, për të kapur një përqendrim të mundshëm të cilësisë së kredisë përtej rritjeve të supozuara nga modeli i kredive me probleme. Kjo

mënyrë përdoret shpesh ose si pjesë e skenarëve (shtesë e kredive me probleme në sektorin e ndërtimit dhe të pasurive të paluajtshme për të kapur ndikimin e një krize të mundshme të tregut të banesave në vijim të një rënijeje të çmimit të tyre etj.) ose për një shtesë të analizës së ndjeshmërisë së sektorëve "të cënueshëm" (turizëm/restorante për një simulim të një situatë stresi si për shembull ajo nga pandemia e SARs-CoV-2etj.).

Metodologjia e mëparshme me modelet e kredive me probleme sipas monedhës lejonte automatikisht të ashtuquajturin "rreziku indirekt i kredisë nga kursi i këmbimit", dmth përkeqësimin e kredive në valutë të huaj në kohë nënçmimesh të mëdha (pasi kosto e shërbimit të borxhit do të rritej dhe do të ishte më e vështirë për t'u përballuar veçanërisht nëse huamarrësi është i pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit). Modelet e reja nuk përfshijnë kursin e këmbimit si një nga variablat e varur (pasi ai nuk ishte i rëndësishëm), por për shkak të pranisë së vazhdueshme të kreditimit në valutë në Shqipëri, u konsiderua e rëndësishme ruajtja e këtij efekti të mundshëm në ushtrimin e provës së rezistencës. Ky element tani zbatohet nëpërmjet shtesave të RKP-së, të cilat janë të lidhura me nivelin e nënçmimit. Ndikimi është specifik për çdo bankë dhe varet nga pesha e kredive të pambrojtura në valutë ndaj tepricës së kredisë të secilës bankë në dy sektorët kryesorë, biznes dhe individë (të dhëna këto që mbledhen rregullisht nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet raportimit periodik nga ana e bankave). Kjo shtesë llogaritet si një funksion i normës së nënçmimit dhe një koeficienti elasticiteti, i cili kap përqindjen e huave të pambrojtura në valutë që do të kthehen në kredi me probleme për shkak të një ndryshimi në kursin e këmbimit. Ky elasticitet u vendos në nivelin 0.2, në vijim të gjyqimit ekspert, që do të thotë se një nënçmim prej p.sh. 15%, do të gjeneronte një shtesë të kredive me probleme sa 3% e vlerës së huave të pambrojtura në valutë. Për më tepër, efekti është përcaktuar që të fillojë vetëm nëse nënçmimi kumulativ që prej fillimit të skenarit është mbi 10%. Ky "jolinearitet" i efektit përfshihet për të pasqyruar faktin se huamarrësit e pambrojtur në valutë vlerësohet se janë të aftë të përballojnë një nënçmim të kursit të këmbimit që luhet nga 5% deri në 10%, por sapo nënçmimi bëhet i konsiderueshëm, ata fillojnë të shfaqin probleme me shlyerjen e detyrimeve ndaj institucioneve financiare.

Tabelë 1: Segmentet e portofolit të kredisë të metodologjisë së re të provës së rezistencës

Korporatat jo-financiare
A Bujqësia, Pyjet, Peshkimi
B Industria nxjerrëse
C Industria përpunuese
D Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar
E Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve
F Ndërtimi
G Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave
H Transporti dhe magazinimi
I Akomodimi dhe shërbimi ushqimor
J Informacioni dhe komunikimi
K Aktivitete financiare dhe të sigurimit
L Aktivitete të pasurive të paluajtshme
MU Shërbime të tjera
Individët
Pasuri të paluajtshme (kredi hipotekare)
Të tjera (kredi konsumatore, karta krediti, overdraft etj.)

Metodologjia e re sjell disa risi në kuadër të rrezikut të kredisë. Së pari, ndikimi i rrezikut jo të drejtëpërdrejtë të kredisë të shkaktuar nga kursi i këmbimit nuk është i vetmi ndikim i nënçmimit të monedhës në portofolin e kredisë. Duke pasur parasysh peshën e madhe të kredive në valutë në portofolet e bankave (rreth 55% për kreditë e korporatave jofinanciare dhe 35% për kreditë e individëve në fund të vitit 2020), nënçmime të mëdha mund të rrisin shpejt vlerat bruto të tepricës së kredisë thjesht nga efekti kontabël (nëpërmjet konvertimit të tepricës së kredisë në valutë me një nivel më të nënçmuar, pra me një kurs këmbimi më të lartë). Në situata të tilla, ceteris paribus, kjo do të rriste gjithashtu tepricën neto të kredisë dhe aktivet e ponderuara me rrezik. Ky efekt kontabël zbatohet për të gjitha bankat, duke përdorur informacionin për të gjithë portofolin e kredisë në valutë, ku përfshihen edhe kreditë e mbrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit.

Së dyti, metodologjia e re i projekton kreditë e klasifikuara në klasën “në ndjekje”, si pjesë përpjestimore e kredive cilësore. Në mungesë të një modeli shtesë, projeksionet mbi vlerën e tyre lidhen me projeksionet e kredive me probleme me një koeficient prej 0.7 (nëse RKP rritet nga 4% në 6%, pra me 50%  $(6/4-1)$ ), rritja e normës

së kredive në ndjekje ndaj normës së kredive performuese do të jetë  $0.7 \cdot 50\% = 35\%$ , p.sh nga 5% në 6.75%). Koeficienti është kalibruar sipas gjykimit ekspert bazuar në analizën e bashkëlëvizjes së raportit të kredive me probleme dhe raportit të kredive në ndjekje ndaj kredive cilësore. .

Kështu, metodologjia e re I e ushtrimit të provës së rezistencës bazohet në tre klasa të cilësisë së kredisë: klasa "standard", klasa "në ndjekje" dhe klasa e "kredive me probleme". Një nga arsyt përse u përzgjedh kjo ndarje, (në vend të përdorimit të pesë klasave të grupuara në klasën cilësore dhe atë jocalësore ose me probleme), është përgatitja për një kalim sa më të lehtë nga provigjionimi prudencial, të bazuar në koeficientë, drejt zbatimit të SNRF 9, të bazuar në humbjet e pritshme të kredisë (Expected Credit Loss). Ky i fundit, konsideron gjithashtu tre klasa (faza) kredie. Ndërsa ky standard (SNRF 9) nuk zbatohet ende në Shqipëri, përshtatja e metodologjisë së re të provës së rezistencës nuk do të jetë i vështirë në moneitin e zbatimit të plotë të SNRF 9. Kjo pasi kreditë standarde do të korrespondojnë kryesisht me kreditë e Fazës 1, ato në ndjekje me kreditë e Fazës 2 dhe kreditë me probleme me kreditë e Fazës 3.

Së treti, metodologjia në fjalë përfshin tashmë fshirjet e detyrueshme të kredive të humbura kur gjeneron projeksionet përfundimtare të kredive me probleme. Sipas rregullores në fuqi, që prej vitit 2015, bankat duhet të fshijnë kreditë pas një periudhe të përcaktuar paraprakisht (bankat duhet të fshijnë kreditë në kategorinë «kredi të humbura» të cilat kanë qëndruar të tilla për 2 vitet e fundit). Meqenëse të dhënat për fshirjet e planifikuara gjatë 3 viteve të ardhshme janë të disponueshme nga Regjistri i Kredive, ato përdoren për të rregulluar projeksionet e RKP-ve të bazuara në modele satelitore. Megjithatë, duke qenë se një pjesë e fshirjeve ishin duke u kryer gjatë periudhës në të cilën u vlerësuan modelat e RKP-së (2005-2020), parashikimet e modelit të RKP-së përfshijnë gjithsesi në mënyrë implicite një pjesë të fshirjeve. Nga ana tjetër, periudha 2005-2020 mbizotërohet nga një kohë në të cilën fshirjet nuk ishin të detyrueshme dhe kryesisht shumë më të vogla se sa do të duhej të fshiheshin pas hyrjes në fuqi të rregullores. . Kështu,

supozohet se rreth 30% e fshirjeve të planifikuarapërfshihen në mënyrë të nënkuptuar në projeksionet e modelit dhe 70% është pjesa shtesë që duhet të zbritet.

Së katërti, ushtrimi i provës së rezistencës merr në konsideratë kreditë e ristrukturuara, të cilat më parë klasifikoheshin si kredi me probleme, por që pas rifillimit të shlyerjes së detyrimit përgjatë një harku kohor të mirëpërcaktuar në rregulloren përkatëse, u zhvendosën drejt klasave cilësore/. Për të llogaritur faktin se këto kredi ishin klasifikuar si jocilësore gjatë historikut të tyre, ndaj tyre zbatohen norma më të larta provigjionimi (10%) në krahasim me normat rregullative në fuqi (1% për kreditë standard dhe 5% për kreditë në ndjekje), ndonëse ato klasifikohen si kredi cilësore/ performuese. Në fund të vitit 2020, niveli mesatar i provigjionimit i raportuar për kreditë standarde ishte 1.7% për bizneset dhe 1.2% për individët, duke sugjeruar që pesha e kredive të ristrukturuara në kreditë standarde ishte rreth 8% për kreditë dhënë bizneseve dhe 2% për individët. Në rastin e kredive në ndjekje, normat mesatare të provigjionimit ishin 8.5% për kreditë për biznese dhe 5.8% për kreditë për individë, gjë që tregon se pesha e kredive të ristrukturuara të kësaj klase ishte në fakt shumë e lartë për kreditë dhënë bizneseve (rreth 70%) kundrejt individëve (rreth 15%). Për sa i përket projeksioneve, supozohet se pesha e kredive të ristrukturuara brenda klasës së kredive standarde mbetet konstante në të gjithë skenarët, kështu që p.sh. nëse rriten kreditë në ndjekje, rriten edhe kreditë e ristrukturuara (të klasifikuara në ndjekje). Kjo çon në një normë të pandryshuar të provigjionimit mesatar të çdo banke, i cili mbahet në nivelin fillestar për të gjitha parashikimet (në të gjithë skenarët dhe vitet).

Së fundi, instrumenti nëpërmjet të cilit kryhet ushtrimi i provës së rezistencës lejon të përcaktohen goditje (rritje) në normën mesatare të provigjionimit të kredive me probleme (raporti i mbulimit të kredive me probleme), për secilin skenar dhe për çdo vit, të cilat aplikohen si shtesa në normën fillestare të provigjionimit specifik të secilës bankë për kreditë me probleme (RKP). Këto goditje përcaktohen si shtesa për çdo vit mbi nivelin e një viti më parë dhe si të tilla mund të akumulohen. Një rritje në raportin mesatar të kredive me probleme është ekuivalente me një përkeqësim të shpërndarjes



së kredive me probleme midis tre klasave jocilësore (peshë më e madhe e kredive me probleme në klasat e huave të dyshimta ose të humbura me norma më të larta provigjionimi). Sipas rregullores, provigjionimi zbatohet për shumat bruto të kredive me probleme. Vlera e kolateralit (nëse ka) nuk merret në konsideratë. Instrumenti më pas projekton flukset e provigjioneve që ndikojnë në llogarinë e të ardhura-shpenzimeve dhe në përfundim, në kapitalin rregullator.

Projeksionet e ekspozimeve të peshuara me rrezikun e kredisë (EPR) funksionojnë nën supozimin se të gjitha ekspozimet përllogariten sipas qasjes së standardizuar të Basel II/III, duke përdorur pesha mesatare rrezikuspecifike për çdo bankë, të cilat zbatohen mbi aktivet neto të ndryshueshme në kohë. Aktivet neto, veçanërisht huatë neto, evoluojnë sipas ecurisë së huave bruto (të cilat gjithashtu kapin efektin kontabël të ndryshimeve të kursit të këmbimit), kredive me probleme dhe niveleve të provigjionimit. Në mënyrë tipike, në skenarë shumë të rënduar, ekspozimit e peshuara me rrezik bien disi për shkak të rënies së kredisë neto të shkaktuar nga mungesa e rritjes së kredisë apo prej normave negative të rritjes, si dhe prej rritjes së kredive me probleme (dhe si rrjedhojë edhe e provigjionimit), duke përmirësuar disi mjaftueshmërinë e kapitalit, gjë që është në përputhje me realitetin.

Kështu, kuadri i provës së rezistencës mund të konsiderohet dinamik (në terma të ecurisë së bilancit) në kuptimin që skenarët përfshijnë supozime rreth rritjes së kredisë bruto, të cilat së bashku me projeksionet e kredive me probleme, efektet kontabël të kursit të këmbimit dhe supozimet e provigjionimit, sjellin ndryshime në aktivet neto përfundimtare. Kështu, madhësia e bilancit nuk mbetet domosdoshmërisht konstante në përqindje ndaj PBB-së. Sidoqoftë, instrumenti i ri nuk lejon ristrukturimin e portofolit, p.sh. rritjen e letrave me vlerë të mbajtura kundrejt portofolit të kredisë ose anasjelltas.

## 4.2 Rreziku i tregut

Elementët kryesorë që përfshihen në ushtrimin e provës së rezistencës në kuadër të vlerësimit të rrezikut të tregut në bilancet e bankave, janë dy: rivlerësimi i ekspozimeve në valutë, për shkak

të ndryshimeve në kursin e këmbimit dhe rivlerësimi i portofolit të letrave me vlerë për shkak të ndryshimeve të normave të interesit në treg.

Rivlerësimi i ekpozimeve në valutë bazohet në pozicionin e hapur neto të raportuar në valutë. Modeli përdor pozicionin e hapur neto fillestar të të gjitha monedhave dhe ndryshimet në kursin e këmbimit ALL/EUR (si një përfrues për ndryshimet e çdo kursi këmbimi të rëndësishëm, si psh ALL/USD, ALL/GBP etj.) për të llogaritur rivlerësimet , të cilat ndikojnë në pasqyrën e të ardhura-shpenzimeve. Duke qenë se shumica e bankave kanë një pozicion të hapur neto pozitiv në valutë (pra, fitojnë kur ka nënçmim) dhe duke qenë se skenarët e rënduar përfshijnë zakonisht nënçmim të lekut, bankat normalisht do të fitonin në vend që të humbisnin në skenarët e rënduar.

Rivlerësimi i letrave me vlerë (bonove dhe obligacioneve) përdor një burim të pasur të dhënash për çdo letër me vlerë të mbajtur nga bankat, duke marrë për secilën bankë vlerën kontabël dhe vlerën e tregut për ekpozimet në bono dhe obligacione për disa vende të përzgjedhura (Shqipëri, Itali, Greqi, Turqi dhe Kosovë) dhe dy grupe të tjera vendesh (Grupi 1 i vendeve me vlerësim të lartë dhe Grupi 2 i cili përfshin të gjitha vendet e tjera). Përveç vlerave të ekpozimit, ka të dhëna specifike për çdo letër me vlerë, gjë që lejon llogaritjen e kohëzgjatjes mesatare të modifikuar për të gjitha vendet e përzgjedhura dhe për të dy grupet. Ky informacion përdoret më tej për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve në yield (normat e interesit) në vlerën e tregut të letrave me vlerë.

Aktualisht, bankat shqiptare i klasifikojnë letrat me vlerë të mbajtura në tre kategori kryesore në bilanc: letra me vlerë të tregtueshme (të cilat vlerësohen me çmimin më të fundit të tregut); letrat me vlerë të investimeve (të cilat vlerësohen me vlerë kontabël dhe mbahen në portofol për qëllime investimi, pra deri në maturim); dhe letrat me vlerë të vendosjes (të cilat nuk vlerësohen me çmimin më të fundit të tregut dhe mbahen në portofol për të paktën për 6 muaj). Kështu, goditjet e normave të interesit do të ndikojnë drejtpërdrejt vetëm letrat me vlerë të tregtueshme, të cilat duhet të rivlerësohen dhe fitimi apo humbja përkatëse regjistruara në llogarinë e të ardhura-

shpenzimeve. Gjithsesi, vetëm një pjesë e letrave me vlerë (zakonisht më pak se 2%) mbahet në klasën “të tregtueshme”, ndërkohë që, shumica e letrave me vlerë mbahen si letra me vlerë të vendosjes (shpesh mbi 60%) ose të investimit (më shumë se 30%), ndonëse midis bankave ka dallime. .

Metodologjia e re lejon përcaktimin se cilat kategori kontabël (përveç letrave me vlerë të tregtueshme) do t’i nënshtrohen gjithashtu rivlerësimit. Ky përcaktim mund të jetë i dobishëm për të treguar një cënueshmëri “ekonomike” (p.sh. si do të ndikohej llogaria e të ardhura-shpenzimeve dhe mjaftueshmëria e kapitalit nëse do të përdorej vlera e tregut dhe jo ajo kontabël). Në të ardhmen, pasi këto kategori të zëvendësohen nga kategoritë tradicionale të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (vlerë tregu për llogarinë e të ardhura-shpenzimeve, për kapitalin dhe me kosto amortizimi), metodologjia mund të përshtatet lehtësisht.

Goditjet ndaj normave të interesit të tregut (yield-et e bonove dhe obligacioneve) janë pjesë e skenarëve, me projeksione për yield-in e bonove të thesarit 12-mujore të qeverisë shqiptare të marra nga Departamenti i Politikës Monetare, ku ndryshimet në këtë yield përdoren për të riçmuar të gjitha bonot dhe obligacionet shqiptare (që do të rivlerësohen). Yield-i 12-mujor përdoret si një tregues përafres. Ka gjithashtu yield-e më të shkurtra (3-mujore, 6-mujore) të bonove dhe më të gjata (3-vjeçare, 5-vjeçare) të obligacioneve me maturime të tilla, por analiza e sjelljes së mëparshme ka treguar një bashkëlëvizje të fortë në të gjitha këto maturitete. Goditjet ndaj yield-eve për vendet e tjera janë kalibruar nëpërmjet gjyqimit ekspert vetëm për skenarin e moderuar dhe atë të rënduar (për skenarin bazë supozohet që nuk ka asnjë ndryshim në yield-et e huaja) dhe ndryshojnë sipas vendeve të marra në konsideratë (pra goditje shumë të vogla ose asnjë goditje për Grupin 1 dhe goditje më të mëdha për vende me luhatshmëri më të lartë si Turqia ose Grupi 2 se sa për vendet që janë pjesë e BE-së). Kalibrimi zakonisht bazohet në luhatshmërinë historike të yield-eve të obligacioneve në vendet e përzgjedhura. Për shembull, do të merrej në konsideratë një goditje prej rreth një deri në tre devijime standarde në ndryshimin vjetor të yield-eve të obligacioneve. Për më tepër, goditja mund të përqendrohet në një periudhë të vetme (siç është viti i parë i

ushtrimit) ose të shpërndahet përgjatë harkut kohor tre vjeçar të ushtrimit. . Në mënyrë tipike, goditjet e tregut japen në vitin e parë të ushtrimit të provës së rezistencës, kështu që zakonisht supozohet të ndodhin në fillim të periudhës ushtrimore.

### 4.3 Të ardhurat, shpenzimet dhe mjaftueshmëria përfundimtare e kapitalit

Metodologjia e re përfshin projeksione të qarta sipas skenarëve për zërat kryesorë të llogarisë së të ardhurave dhe shpenzimeve: të ardhurat neto nga interesi, të ardhura të tjera të veprimtarisë (jo nga interesi), shpenzime të tjera (administrative), rivlerësime, provigjione dhe taksa.

Të ardhurat neto nga interesi parashikohen për çdo bankë si produkt i marzhit të saj neto nga interesat dhe aktiveve që sjellin interes, të cilat janë të ndryshueshme në kohë dhe specifike për çdo skenar. Marzhi neto nga interesat përkufizohet si të ardhurat neto nga interesi ndaj aktiveve që sjellin interes dhe modeli përdor nivelin fillestar të raportuar (të llogaritur gjatë periudhës së kaluar ose 2 viteve të fundit) si një pikënisje për secilën bankë (që gjithsesi mund të përshtatet për skenarë të ndryshëm). Në mënyrë tipike, marzhi neto nga interesat mbahet konstant në nivelin e vitit paraardhës në skenarin bazë, ndërkohë që supozohet një marzh i vogël reduktues në krahasim me nivelin e vitit paraardhës për skenarët e rënduar. Ekziston një lidhje e fortë midis projeksioneve të rrezikut të kredisë dhe projeksioneve të të ardhurave neto nga interesi, pasi aktivet që sjellin interes përshtaten me kreditë e reja me probleme (kreditë me probleme nuk gjenerojnë të ardhura nga interesi). Pra, gjatë periudhave të rënies ekonomike, edhe nëse marzhi neto nga interesi mbetet i njëjtë, të ardhurat neto nga interesi bien, për shkak të rënies së nivelit të kredive cilësore.

Të ardhurat dhe shpenzimet e tjera të veprimtarisë (p.sh. zëra të tjerë në pasqyrën e të ardhura-shpenzimeve përveç të ardhurave neto nga interesi dhe humbjet nga kreditë) parashikohen si një funksion i vlerës së vëzhguar në periudhën paraardhëse (ose mesatares së

2 viteve të fundit), ku të ardhurat e tjera të veprimtarisë mund të rregullohen nëpërmjet një marzhi reduktues specifik për skenarin (zakonisht një rënie prej rreth 10%-20% në skenarët e rënduar). Rivlerësimet dhe humbjet prodhohen nga kontributi i rrezikut të tregut dhe rrezikut të kredisë në provat e rezistencës. Norma tatimore për fitimet e bankave është përcaktuar në nivelin 30 për qind dhe aplikohet vetëm për të ardhurat pozitive neto.

Modeli i ushtrimit të provës së rezistencës kërkon gjithashtu të specifikohet përqindja e shpërndarjes së dividendit, i cili është specifik për çdo bankë dhe për secilin vit. Kjo ndikon mbi pjesën e fitimit që do të shpërndahet sipas çdo viti, ndërsa pjesa e mbetur mbahet si fitim i pashpërndarë dhe i shtohet kapitalit rregullator (fitimi i vitit aktual nuk është pjesë e kapitalit rregullator, i shtohet vetëm pjesa që supozohet të mbahet pasi fitimi certifikohet nga auditimi dhe pasi merret vendimi i mbledhjes së aksionarëve për shpërndarjen e fitimit). Në këtë mënyrë, në rast mosshpërndarje të dividendit, i gjithë fitimi neto mbahet si fitim i pashpërndarë dhe përfshihet si i tërë në kapitalin rregullator; në rastin e një shpërndarjeje të dividendit në nivelin 100%, kapitali rregullator nuk do të ndryshojë, pasi i gjithë fitimi shpërndahet. Në rast të të ardhurave neto negative, nuk ka shpërndarje dividendi dhe humbja zbritet direkt nga kapitali rregullator.

Rezultatet përfundimtare të provës së rezistencës raportohen në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit. Për këtë qëllim, realizohen projeksione specifike për çdo skenar për kapitalin rregullator, kapitalin bazë të nivelit të parë (KBN1), kapitalin e nivelit të parë dhe ekspozimet e peshuara me rrezik. Sa më lart rezulton në raporte të mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) për secilën bankë, të cilat më pas krahasohen me kërkesat rregullative specifike të RMK-së për çdo bankë (përfshirë shtesat e Shtyllës 2 dhe, në mënyrë opsionale, shtesat e kombinuara të kapitalit). Instrumenti më pas llogarit shtesat e kapitalit që nevojiten për të sjellë të gjitha bankat në nivelin minimal të kërkuar të RMK-së. Ekspozimet për rrezikun e kredisë përgatiten si pjesë e projeksioneve të rrezikut të kredisë, ndërsa përlllogaritja e ekspozimeve në kuadër të rrezikut të tregut dhe të rrezikut operacional, për thjeshtësi mbahen konstante.

## **5. REZULTATET E PROVËS SË REZISTENCËS TË KRYER NË FILLIM TË VITIT 2022**


Për qëllime ilustrimi, materiali studimor përdor, rezultatet e provës së rezistencës të kryer në pranverën e vitit 2022, periudhë në të cilën metodologjia e re u përdor për herë të parë zyrtarisht në kuadër të analizës përkatëse në Raportin e Stabilitetit Financiar. U ndërtuan tre skenarë: skenari bazë, skenari i moderuar dhe skenari i rënduar, ku në secilin prej tyre përcaktoheshin në mënyrë specifike me një frekuencë tremujore katër variablat kryesorë makroekonomikë (rritja e PBB-së, norma e papunësisë, norma e interesit 1 2-mujore dhe kursi i këmbimit), si dhe çmimet e banesave e rritja e kredisë. Ndonëse prova e rezistencës ofron mundësinë e zbatimit të skenarëve për një hark kohor deri në 3 vjet, për të testuar metodologjinë e re është përdorur një hark kohor 2-vjeçar, pra për periudhën 2022-2023.

Skenari bazë supozon një normë rritjeje ekonomike pozitive për periudhën ushtrimore. Në këtë skenar, rritja ekonomike shoqërohet me një rritje të ndjeshme të kreditimit dhe një përmirësim të cilësisë të portofolit të kredisë, bazuar edhe në procesin e fshirjeve të pritshme të kredive të humbura nga portofoli i bankave. Në terma të rrezikut të tregut, në këtë skenar është konsideruar edhe rivlerësimi i letrave me vlerë të investimit dhe të vendosjes. Në skenarin e moderuar, rritja ekonomike vlerësohet pozitive përgjatë periudhës ushtrimore, por me një normë rritjeje më të ulët; ndërsa në kuadër të rivlerësimit të letrave me vlerë, në këtë skenar janë rivlerësuar vetëm letrat e investimit. Në skenarin e rënduar supozohet një normë rritjeje pozitive në fundin e vitit të parë ushtrimor, ndjekur nga një tkurrje ekonomike (Figurë 6). Gjithashtu, në të tre skenarët është marrë në konsideratë pezullimi i shpërndarjes së dividendit nga ana e bankave<sup>12</sup>, deri në fund të vitit 2022.

---

<sup>12</sup> Sipas Vendimit Nr. 6, dt. 02.02.2022 të Këshillit Mbikëqyrës "Për pezullimin e shpërndarjes së fitimit nga bankat".


Figurë 6: Projeksionet mbi treguesit kryesorë makroekonomikë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjithashtu, parashikimet për treguesit e rinj makroekonomikë të përfshirë në ushtrim, tregojnë një rënie të çmimeve të banesave përgjatë vitit 2022 në skenarët më të pafavorshëm, si edhe një rritje të normës së papunësisë (Figura 7).


Figurë 7: Projektionet mbi treguesit e rinj makroekonomikë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Supozimeve për ecurinë më të dobët ekonomike në skenarin e moderuar dhe në atë të rënduar, i mbivendoset nënçmimi i kursit të këmbimit të monedhës vendase, rritja e normave të interesit dhe ulja e ritmit të kreditimit, deri në një mungesë të kredithënies (Figurë 8). Këto zhvillime reflektohen në një përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredisë, si për bizneset, ashtu edhe për individët.

Figurë 8: Projektionet mbi portofolin e kredisë për bizneset dhe individët



Burimi: Banka e Shqipërisë.




Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit tregojnë se:

Në skenarin bazë, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) të sektorit bankar shfaq një prirje rritëse, duke arritur në 21.9% në fund të vitit 2022 dhe 21.5% në fund të vitit 2023. Këto zhvillime tregojnë një qëndrueshmëri dhe nivele të larta të kapitalizimit për të gjithë sektorin bankar. Gjithsesi, duke marrë në konsideratë kërkesat rregullative shtesë sipas bankave individuale, zhvillimet në banka të veçanta evidentojnë nevojën për injektim kapitali gjatë periudhës kohore ushtrimore. Numri i bankave që paraqiten të nënkapitalizuara për këtë skenar është pesë deri në fund të vitit 2023, duke përbërë 17.2% të aktiveve të sektorit. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë vlerësohen të jenë rreth 3.5 miliardë lekë (rreth 0.1% e PBB-së).

Në skenarin e moderuar, RMK për sektorin bankar ulet lehtësisht në nivelin prej 17.5% në fund të vitit 2022 dhe 16.2% në fund të vitit 2023. Bazuar në rezultatet e përfuara, për banka të veçanta evidentohet nevoja për injektim kapitali në fund të periudhës ushtrimore. Më konkretisht, numri i bankave që paraqiten të nënkapitalizuara shkon deri në tetë në fund të vitit 2023, duke përbërë 54.2% të aktiveve të sektorit. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë vlerësohen të jenë rreth 16.6 miliardë lekë (rreth 0.6% e PBB-së).

Edhe në skenarin e rënduar sektori bankar mbetet i kapitalizuar, por RMK bie nga niveli 18.3% në fund të vitit 2022 në nivelin 15.3% në fund të vitit 2023.


Figurë 9: Rezultatet e provës së rezistencës - raport i mjaftueshmërisë së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kontribut kryesor në rënien e kapitalizimit për këtë skenar paraqet kryesisht humbja nga huatë dhe nga të ardhurat e tjera neto. Numri i bankave që paraqiten të nënkapitalizuara për këtë skenar është shtatë në fund të vitit 2023, duke përbërë 48.7% të aktiveve të sektorit. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë vlerësohen të jenë rreth 20.1 miliardë lekë (rreth 0.8% e PBB-së).

Figurë 10: Rezultatet e provës së rezistencës sipas grupeve të bankave




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bankat sistemike (BARS) në tërësi paraqesin një nivel të qëndrueshëm kapitalizimi prej 17% në fund të vitit 2023 për skenarin e rënduar, ndërkohë që grupi i bankave të tjera paraqitet i nënkapitalizuar, me një normë prej 10.6%. Diferenca midis këtyre dy grupeve vjen nga një kontribut më i ulët i humbjeve nga huatë dhe nga të ardhurat e tjera neto për BARS, si edhe nga një fitim i pashpërndarë më i lartë për këtë grup bankash.

Grupi i bankave me kapital të huaj paraqet një nivel të mirë kapitalizimi prej 17% në fund të vitit 2023 për skenarin e rënduar, ndërkohë që grupi i bankave me kapital vendas shënon një normë prej 11.6%. Diferenca midis grupeve vjen nga një kontribut më i lartë i humbjeve nga huatë dhe nga rënia e të ardhurave të tjera neto për bankat me kapital vendas.

Në përfundim të ushtrimit, analiza tregon që sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve makroekonomike, por banka të veçanta paraqesin ndjeshmëri të lartë ndaj skenarëve të supozuar. Në kushte të skenarëve me ekstremitet më të lartë, nevojat e injektimit të kapitalit arrijnë një peshë maksimale prej rreth 0.8% të PBB-së, në fund të vitit 2023 në skenarin më të rënduar (Figurë 11).<sup>13</sup>

Figurë 11: Rezultatet e provës së rezistencës - nevojat për kapital shtesë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>13</sup> Pa përfshirë shtesat makroprudenciale.

## 6. KONKLUZIONE DHE SFIDAT E SË ARDHMES

Metodologjia e re e provës së rezistencës ofron një kuadër më të pasur për të testuar skenarë të ndryshëm dhe për të ndërtuar projeksione të besueshme mbi bilancet e bankave, llogarinë e të ardhura-shpenzimeve dhe mjaftueshmërinë e kapitalit. Ushtimi i provës së rezistencës sipas qasjes nga lart-poshtë është një instrument i dobishëm për informimin e politikëbërësve në lidhje me qëndrueshmërinë e sektorit bankar dhe mund të luajë një rol thelbësor në kalibrimin e disa instrumenteve makroprudenciale, siç është shtesa kundërciklike e kapitalit, sipas praktikave të vendeve të tjera, si p.sh. Mbretëria e Bashkuar (Kohn 2019).

Metodologjia e re provës së rezistencës mund të përditësohet relativisht lehtë edhe nëse ka zhvillime të reja rregullative. Ajo mund të përshtatet në të ardhmen në rastin e një zhvendosjeje të mundshme drejt provigjionimit të humbjeve të pritshme të kredisë sipas SNRF 9 dhe për ndryshime në kategoritë kontabël në të cilat mbahen letrat me vlerë. Gjithashtu, modelet e kredive me probleme mund të rivlerësohen dhe përmirësohen me kalimin e kohës me të dhëna të reja. Gjithsesi, edhe nëse prova e rezistencës mund të përshtatet teknikisht me mënyrën e provigjionimit sipas SNRF 9, kompleksiteti i llogaritjes së nivelit të provigjionimit sipas humbjeve të pritshme të kredisë për çdo skenar do të jetë sfidues dhe do të kërkojë të dhëna dhe analiza shtesë.

Në Shqipëri, ushtimi i provës së rezistencës kombinon elementë makroprudencialë dhe mikroprudencialë dhe i shërben autoritetit vendimmarrës si një instrument jo vetëm në periudha me stabilitet ekonomik e financiar, por edhe në periudha stresi apo krize. Në të tilla raste, rreziqet sistemike dhe ato të veçanta priren të ndikojnë njëri-tjetrin, pasi i gjithë sektori bankar mund të preket dhe problematikat mund të transmetohen nga një bankë në tjetrën. Ndonëse metodologjia e re nuk ka një instrument të veçantë për të vlerësuar shkallën e ndërlidhjes financiare të sektorit bankar, një instrument i tillë është ndërtuar paralelisht në Bankën e Shqipërisë dhe përdoret rregullisht për të vëzhguar rrezikun e lartpërmendur.

Për sa i përket të ardhmes, Banka e Shqipërisë po konsideron gjithashtu përditësimin e metodologjisë për provat e saj mikroprudenciale të rezistencës, në përputhje me provën të rezistencës sipas qasjes nga lart-poshtë, në mënyrë që të jenë më të krahaseshme. Një sfidë tjetër e rëndësishme është integrimi i provës së rezistencës së aftësisë paguese me provën e rezistencës së likuiditetit, pasi kryerja e një ushtrimi të përbashkët është një çështje komplekse. Është mjaft e rëndësishme që të ketë një përpjekje për t'i lidhur ato në një mënyrë të përshtatshme, pasi aftësia paguese dhe rreziku i likuiditetit ndikojnë në realitet të njëri-tjetri.

## REFERENCA:

Banka e Shqipërisë (2022): "Raporti i Stabilitetit Financiar - gjashtëmujori i parë 2022";

Banka e Shqipërisë (2019): "Raporti i Stabilitetit Financiar - gjashtëmujori i parë 2019";

Budnik, K. et al. (2020): "Modeli i provës së rezistencës bankare të eurozonës", Banka Qendrore Evropiane, material studimor nr. 2469;

BCBS (2017): "Prova e rezistencës bankare dhe mbikëqyrëse: varg praktikash", Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare;

BCBS (2018): "Parimet e provës së rezistencës", Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare;

Dent et al. (2016): "Prova e rezistencës për bankat: një hyrje", Banka e Anglisë, Buletini tremujor 2016 T3, fq. 130-143;

Kohn, D. (2019): "Prova e rezistencës dhe shtesa kundërciklike e kapitalit: përvoja në Mbretërinë e Bashkuar", Brookings Institution, material studimor 2019/09;

Sejko, G., Dushku E. (2018): "Zhvillimi financiar dhe rritja ekonomike në Shqipëri: evidenca të reja", Libri i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë "Studime mbi sektorin bankar dhe zhvillimin ekonomik";

Shijaku G. (2016): "Kreditimi në valutë në Shqipëri", Banka e Shqipërisë, material studimor.







CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Bozdo, Juna

Ushtrimi i provës së rezistencës së sektorit  
bankar në Shqipëri / Juna Bozdo, Arisa Goxhaj  
(Saqe), Adam Gersl. - Tiranë : Banka e Shqipërisë, 2024.  
52 f. ; 21X15 cm

ISBN 9789928262660

I.Goxhaj (Saqe), Arisa

II.Gersl, Adam

1.Banka dhe veprimtaria bankare 2.Banka e Shqipërisë

336.711(496.5)







[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

ISBN 978-992826266-0



9

789928

262660